



|                                                                        |          |
|------------------------------------------------------------------------|----------|
| REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /<br>REPUBLIC OF KOSOVO         |          |
| QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT                                           |          |
| MINISTRIA E EKONOMISE<br>MINISTARSTVO EKONOMIJE<br>MINISTRY OF ECONOMY |          |
| Njesia Org.<br>Org. Jedin<br>Org. Unit                                 | 01       |
| Nr. i fazeve<br>Broj stranica<br>No. pages                             | 1        |
| Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No.                                    | 2231     |
| Datum:                                                                 | 21.05.25 |
| PRISTINE/A                                                             |          |
| NO. 1                                                                  |          |

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije – Ministry of Economy**

Ministria e Ekonomisë, mbështetur në nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura dhe nenin 15.11 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, në pajtim me pikat 13.6 dhe 13.7 të të Shtojcës së Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, merr:

**V E N D I M**

1. **Z. Habil Zeqiri** caktohet ushtrues detyre i kryesuesit të bordit të drejtorëve në Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Hidromorava” ShA Gjilan (“Ndërmarrja”), deri në emërimin e kryesuesit ose emërimin e bordit të ri të drejtorëve nga Qeveria.
2. **Obligohet** Ndërmarrja të zbatojë këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Kryesuesja e bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes, e emëruar me Vendimin e Qeverisë nr. 03/173 të datës 16.11.2023, ka dhënë dorëheqje. Më 08.03.2025, ka përfunduar mandati i rregullt trevjeçar i bordit të drejtorëve, dhe ndërkohë ka filluar ecuria e rekrutimit të bordit të ri. Bordi i tanishëm mbetet në detyrë deri në emërimin e bordit të ri, sipas nenin 164.3 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

Për të mënjeluar pengesat në mbarëvajtjen e punës së bordit të drejtorëve në këto rrethana, në përputhje me nenin 15.11 të Ligjit për ndërmarrjet publike, u vendos si në dispozitiv.

Artane RIZVANOLLI

Ministre

**U dërgohet:**

- Z. Habil Zeqiri
- KRU Hidromorava
- Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
- Arkivit të Ministrisë